

18 Qershor 2025

Të nderuara familje,

Shkollat tona janë thjesht më të mira kur fëmijët tuaj janë të pranishëm — dhe nuk kemi mbaruar ende! Mësimi vazhdon deri **të enjten, më 26 qershor 2025**, dhe çdo ditë mbart mësim kuptimplotë, festime të gëzueshme dhe kujtime të paharrueshme.

Qershori është një periudhë e veçantë e vitit. Nxënësit po përmbyllin mësimet të rëndësishme, po lidhen me miqtë dhe mësuesit e tyre dhe po përgatiten për kalime emocionuese në fazat e ardhshme. Stafi ynë i mrekullueshëm është këtu çdo ditë për t'i mbështetur, për të festuar dhe për t'i udhëhequr nëpër këto ditë përmbyllëse. Ne duam që çdo nxënës ta përfundojë vitin me sukses!

Çdo ditë ka rëndësi. Kërkimet tregojnë se fëmijët e kopshteve që marrin pjesë rregullisht në programet e edukimit të hershëm kanë *pesë herë* më pak gjasa të mungojnë vazhdimisht deri në klasën e dytë. Që nga kopshti e tutje, zakonet e forta të pjesëmarrjes mbështesin leximin në nivel klase, suksesin afatgjatë akademik dhe në fund diplomimin nga shkolla e mesme. Zakonet që ndërtojmë tani hapin dyer për të ardhmen.

Edhe pse vera po afrohet me nxehtësinë e saj, shkollat tona po qëndrojnë “të freskëta”—si në kuptimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe në atë figurativ! Shkollat tona janë një vend i shkëlqyer për të qenë!

- Klasat tona janë të përgatitura për motin e ngrohtë me ajër të kondicionuar që e bën të rehatshëm procesin e të mësuarit.
- Javët e Frymës Pozitive (Spirit Weeks) janë në kulm të tyre, duke sjellë argëtim, energji dhe ndjenjë komuniteti në shkollat tona.
- Ka ende shumë për të përjetuar—mos i humbni këto ditë të fundit plot mësim dhe buzëqeshje!

Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit Weather Emergency Procedures webpage (Procedurat për Emergjencat me Motin) në schools.nyc.gov/emergency-readiness për më shumë informacion mbi mënyrat për të qëndruar të sigurt gjatë nxehtësisë ekstreme. Kjo faqe përfshin gjithashtu një link për Shërbimin Kombëtar të Motit (National Weather Service) për informacion të përditësuar mbi motin në ditët në vijim.



Kancelare (Chancellor) Melissa Aviles-Ramos

Le ta bëjmë që çdo ditë e mbetur të ketë rëndësi. Nëse keni nevojë për mbështetje për të sjellë fëmijën tuaj në shkollë, ne jemi këtu për të ndihmuar. Ju lutemi kontaktoni me **drejtorin, zëvendësdrejtorin, këshilltarin e shkollës ose koordinatorin e prindërve të shkollës suaj**—do të punojmë së bashku për të siguruar që fëmija juaj ta përfundojë vitin shkollor me sukses.

Faleminderit që jeni partner në arsimimin e fëmijës tuaj. Le ta përfundojmë këtë vit me krenari, qëllim dhe plot buzëqeshje.

Në bashkëpunim,

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Melissa Aviles-Ramos'.

Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)